

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, duke u bazuar në Statutin e QKMF – së, neni 11.7 dhe neni 12 pika 6, me qëllim të themelimit të Këshillit të Pacientëve me datë 28.08.2026 e publikon këtë:

FTESE PUBLIKE

“PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË PACIENTËVE”

Me hyrjen në fuqi të Statutit të QKMF - së, përkatësisht nenin 12.6, është paraparë edhe themelimi i Këshillit të Pacientëve. Me qëllim të zbatimit të këtij neni, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale fton të gjithë qytetarët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij këshilli.

Këshilli i Pacientëve do të përbëhet nga 5 persona dhe do të ketë mandat 3 vjeçar.

Mandati, kriteret, detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në Rregulloren për Themelimin dhe Funksionimin e Këshillave të Pacientëve dhe Kodin e Etikës së Këshillave.

Propozimet duhet të dorëzohen nga data 02.09.2026 deri me datë 17.09.2026 në QKMF ose në zyrën e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Të gjitha propozimet e pranuar pas këtij afati, nuk do të merren parasysh nga komisioni.

Dokumentet e kërkuara:

1. Aplikacioni për të qenë anëtar i këshillit;
2. Kopja e Letërnjoftimit;
3. Një letër motivuese pse dëshironi të jeni anëtar i këshillit.

Termet e Referencës:

Në Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare është paraparë edhe themelimi i Këshillit të Pacientëve si një mekanizëm formal i angazhimit të qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Për këtë qëllim, DSHPS ka hapur thirrje publike për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë që janë të interesuar të jenë pjesë e Këshillit të Pacientëve.

Qëllimi i Këshillit të Pacientëve është që të shërbej si një mekanizëm formal për përfshirjen e pacientëve në vendimmarrje në mënyrë që të punojnë së bashku me institucionet dhe stafin shëndetësor për të rritur cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe komunitetin.

Objektivat e Këshillit të Pacientëve do të jenë:


- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi shëndetin e tyre dhe shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore;
- Identifikimi i problemeve të pacientëve;
- Ndërtimi i besimit ndërmjet Stafit Shëndetësor dhe Pacientëve;
- Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë pacientëve;
- Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në fushën e shëndetësisë;

Fushëveprimi i këshillit të pacientëve shtrihet brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë dhe merret me përfaqësimin e interesave dhe brengave të pacientëve brenda kësaj komune;

Anëtarësimi në Këshill të Pacientëve është i hapur. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, nuk janë anëtar të ndonjë partie politike, të cilët nuk ofrojnë shërbime shëndetësore ose farmaceutike dhe nuk kanë të kaluar kriminale.

Këshilli do të përbëhet prej 5 anëtarëve dhe do të ketë një mandat 3 vjeçar me mundësi vazhdimi.

Drejtoria e DSHPS-së



FORMA E APLIKIMIT:

EMRI: _____

MBIEMRI: _____

ADRESA: _____

DATËLINDJA: _____

SHKOLLIMI: _____

PROFESIONI _____

KONTAKTI: _____

TEL: _____

EMAIL: _____

A KENI QENË NË TË KALUARËN:

- a) PACIENT
- b) PËRCJELLËS I PACIENTIT
- c) ASNJËRA NGA KËTO

JU LUTËM NA TREGONI SE PSE DËSHIRONI TË JENI PJESË E KËSHILLIT TË PACIENTËVE:

Nënshkrimi i aplikuesit:

Data:
